



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 168 prot.

Kamëz, më 22.12.2021

V E N D I M

Nr. 136 Datë 22/12 2021

MBI

‘MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK
KAMËZ PËR PERIUdhËN JANAR 2022-DHJETOR 2022’.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 22.12.2021, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.126 Datë 17.12.2021 në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë ‘‘Qeverisja Vendore’’ e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 ‘‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’’ e ndryshuar , neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1 , gërma ‘‘b’’, të nenit 51, pika 3, neni 54 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 ‘‘Për Vetëqeverisjen Vendore’’ i ndryshuar dhe në zbatim të Rregullores së Funkcionimit dhe Organizmit të Këshillit Bashkiak, , Neni 119 ‘‘Programi i Punës së Këshillit Bashkiak’’ dhe sipas relacionit të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve, **Këshilli Bashkiak Kamëz’’;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e programit të punës së Këshillit të Bashkisë Kamzë për periudhën Janar 2022 – dhjetor 2022, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatim të këtij vendimi Këshilli Bashkiak Kamëz dhe administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 ‘‘Për vetëqeverisjen vendore’’, i ndryshuar).
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë.**

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

